



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 446 Prot.

Tiranë, më 02.07 2015

VENDIM Nr. 65 datë 23.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Kërkime për Paleolitin dhe Mezolitin në Shqipëri"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Ilir Gjipali (IA) dhe Prof. Jurgen Richter (Institutit i Prehistorisë, Universiteti i Këlnit, Gjermani),

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Kërkime për Paleolitin dhe Mezolitin në Shqipëri"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Ilir Gjipali (IA) dhe Prof. Jurgen Richter (Institutit i Prehistorisë, Universiteti i Këlnit, Gjermani) në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Për vitin 2015, veprimtaria në terren do të ketë dy zona objekt kërkimi, atë të Butrintit (Shën Mitrin) dhe Zonën shpellore të Laç-Bruçit në rrethin e Matit (në Shpellën e Blazit, Këputës, Nezirit dhe në Shpellën e Birme ose të Valit).
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë 1 Shtator - 15 Tetor 2015.
- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO-FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al